


# SHERBESA E KUNGATES HYJNORE



BOTIMI  
KISHES ORTHODHOKSE AUTOQEFALE TE SHQIPERISE  
TIRANE 1999

**Shërbesa e  
Kungatës Hyjnore**

Botohet me miratimin dhe bekimin e  
Fortlumturisë së Tij Anastasit,  
Kryepiskop i Tiranës  
dhe i gjithë Shqipërisë

*Kur dëshiron që të kungohesh me misteret e kulluara, në mbrëmje lexo shërbesën e Pasdarkës deri në: Besoj në një Perëndi ... dhe pastaj thuaj me shpresëtar kanonin e mëposhtëm:*

## KANONI

### *Kënga I. Tingull II*

*Sipas irmosit: Dhefte llai*

Bukë e jetës së përjetshme le të më bëhet Trupi yt i shenjtë, o Zot i mëshirshëm, dhe shërim dhimbjesh të shumëllojshme, Gjaku yt i çmuar.

Bëmë të denjë, o Zot, mua të pavyerin, të kungohem me besim e dashuri me Trupin tënd të kulluar dhe me Gjakun tënd të çmuar.

*Hyjlindësore (Theotokio)*

O nuse hyjnore e bekuar, tokë e mirë, që mbive kallirin e pambjellë dhe shpëtimtar për botën, bëmë të denjë që, duke e ngrënë këtë, të gjej shpëtim.

### *Kënga III*

*Sipas irmosit: En petra me tis pisteos.*

Jepmë, o Krisht, pika lotësh për pastrimin e njollave të zemrës, që duke qenë i pastër, o Zot, në ndërgjegje, të vij me besim e frikë të kungohem me dhuratat e Tua.

Le të jetë për mua Trupi yt i kulluar dhe Gjaku yt hyjnor për ndjesë fajesh, për kungim të Shpirtit të Shenjtë, për jetë të përjetshme dhe për largim pësimesh dhe hidhërimesh, o njeridashës.

#### *Hyjlindësore ( Theotokio)*

O e Tërëshenjtë, tryezë e bukës së jetës, e cila zbriti nga mëshira së larti dhe i dhuroi botës jetë të re, bëmë të denjë tani dhe mua të padenjin, që të shijoj nga ajo me frikë dhe të gëzoj jetën.

### *Kënga IV*

*Sipas irmosit: Elilithas ek parthenu.*

U trupëzove, o i Shumëmëshirshëm, dhe me vetëdashje e dhe veten tënde në therje si një qengj për fajet e njerëzve; prandaj të lutem, shuaji edhe fajet e mia.

Shëroi, o Zot, plagët e shpirtit tim, dhe  
mua të tërë shenjtëromë dhe bëmë të de-  
një, o Zot, të jem dhe unë i mjeri pjesëtar  
në Darkën tënde hyjnore mistike.

*Hyjlindësore (Theotokio)*

Ndërmjeto, o Zonjë, që Ai që lindi nga  
gjiri yt, të jetë edhe kundrejt meje i më-  
shirshëm, dhe ruajmë të jem i panjoll-  
shëm e i pastër, mua shërbëtorin tënd lu-  
tës, që duke pranuar margaritarin shpir-  
tëror, të shenjtërohem.

*Kënga V*

*Sipas irmosit: O tu fotos korigos.*

Siç e the që më parë, o Krisht, le të bëhet  
për mua shërbëtorin tënd të përulur; dhe  
siç premtove, mbetu tek unë, se ja tek po  
ha Trupin dhe pi Gjakun tënd hyjnor.

O Fjalë e Perëndisë dhe Perëndi, le të jetë  
ndriçim për mua të errësuarin thëngjilli  
i trupit tënd dhe pastrim për shpirtin tim  
të ndyrë Gjaku yt i çmuar.

*Hyjlindësore (Theotokio)*

O Hyjlindëse Mari, enë e nderuar e erës  
së këndshme, bëmë dhe mua, me uratat e  
tua, enë të zgjedhur që të kungohem me  
Misteret e Shenjta të Birit tënd.

*Kënga VI*

*Sipas irmosit: En aviso ptesmaton.*

Mendjen, shpirtin, zemrën dhe trupin  
tim shëroi, o Shpëtimtar, dhe bëmë të de-  
një t'u afrohem pa dënim Mistereve të  
Tua të frikshme.

U largofsha nga pasionet, dhe u shumoftë  
hiri yt mbi mua e u bëftë sigurim jete me  
anën e kungimit të Mistereve të Tua të  
Shenjta, o Krisht.

*Hyjlindësore (Theotokio)*

O Fjalë e shenjtë e Perëndisë dhe Perë-  
ndi, tani që po vij në Misteret e Tua të  
hyjshme, shenjtëromë të tërë, me ndër-  
mjetimet e Nënës sate të shenjtë.

*Shkurtore (Kondaqi). Tingulli II*

*Sipas: Ta ano ziton.*

Mos më përbuz, o Krisht, tani që po vij të marr Bukën, që është Trupi dhe Gjaku yt hyjnor, dhe duke u kunguar unë mëkatori me Misteret e Tua të kulluara e të frikshme, të mos gjej dënimin, o Zot, por jetën e përjetshme dhe të pavdekshme.

*Kënga VII*

*Sipas irmosit: Ikonos krisis.*

Kungimi me Misteret e Tua të pavdekshme, o Krisht, le të bëhet tani për mua burim mirësish, dritë, jetë, mospësim dhe nxitje përparimi e arritjeje të një virtyti më hyjnor, që të të lavdëroj Ty, të vetmin të mirë.

Tani që po afrohem me tmerr, me dëshirë dhe me shpresëtarë në Misteret e Tua hyjnore dhe të pavdekshme, o njeridashës, dhe të këndoj: i bekuar je, o Perëndi i etërve tanë, shpëtofsha nga pësimet, armiqte, nevojat dhe nga çdo hidhërim.



*Hyjlindësore (Theotokio)*

Ty, o Hirëplote, që linde në mënyrë të pakuptueshme prej mendjes Shpëtimtarin Krisht, të lutem Ty, o e kulluar, edhe unë shërbëtori yt i papastër: Tani që po u afrohem Mistereve të kulluara, pas-tromë krejt prej çdo ndotjeje të trupit dhe të shpirtit.

*Kënga VIII*

*Sipas irmosit: Ton en kamino tu piros.*

O Perëndi, shpëtimtari im, bëmë të denjë dhe mua të dëshpëruarin, të bëhem tani pjesëtar i Mistereve të Tua të shenjta, të frikshme dhe qiellore, o Krisht, dhe i Darkës sate hyjnore dhe mistike.

Duke u strehuar nën mëshirën tënde, o i Mirë, të thërres me frikë: Mbetu tek unë, o Shpëtimtar, dhe unë tek Ti, ashtu siç ke thënë; sepse ja, duke marrë guxim nga mëshira jote, po ha Trupin tënd dhe po pi Gjakun tënd.

## Hyjlindësore (*Theotokio*)

Duke pritur zjarrin dridhem se mos digjem si qiriu dhe si bari. O mister i frikshëm! O mëshirë e Perëndisë! Si, unë, balta, kungohem me Trupin tënd dhe me Gjakun tënd hyjnor dhe fitoj mosprishjen?

## Kënga IX

*Sipas irmosit: Anarku genitoros.*

Shijoni dhe shihni se Zoti është i mirë, se duke u bërë dikur si ne për ne, dhe duke ia sjellë një herë vetveten therore Atit të tij, gjithmonë therorizohet dhe shenjtëron pjesëmarrësit.

Le të shenjtërohem trupërisht dhe shpirtërisht, o Zot, le të ndriçohem, le të shpëtoj, le të bëhem banesa jote, duke u kunguar me Misteret e shenjta, duke të pasur Ty banues bashkë me Atin e me Shpirtin, o mirëbërës dhe shumë i mëshirshëm.

Si zjarri dhe si drita le të më bëhen Trupi dhe Gjaku yt shumë i çmuar, o Shpëtimtari im, duke djegur lëndën e mëkatit,

duke përvëlur gjembat e pasioneve dhe duke më ndriçuar krejt që t'i falem Hyjnisë sate.

*Hyjlindësore (Theotokio)*

Perëndia u trupëzua prej Gjakut tënd të kulluar; prandaj të lavdëron çdo brez, o Zonjë; ty të madhërojnë rreshtat e engjëjve, sepse me anën tënde panë qartë Atë që sundon mbi të gjitha, që u bë njeri.

*Pastaj thuhet:*

Të meriton me të vërtetë të të lumturojmë ty, Hyjlindësen, gjithmonë të lumturën dhe të përmbikulluarën dhe Nënë e Perëndisë sonë. Më të nderuarën se keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se serafimet, që pa u cenuar lindi Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen, ty të madhërojmë.

Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshirona (3 herë).

Lavdi Atit..... Tani.....

Trini e Tërëshenjtë, mëshirona; o Zot, falna mëkatet tona; o Zot i madh, ndjei

paudhësitë tona; o i Shenjtë, vështro dhe shëro sëmundjet tona, për emrin tënd.

Mëshiro, o Zot (3 herë).

Lavdi Atit..... Tani.....

Ati ynë që je në qiejt, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote si në qiell ashtu edhe mbi dhë. Bukën tonë të përditshme jepna neve sot, dhe falna fajet tona sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë; dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

*Dhe vazhdon shërbesa e Pasdarkës deri në fund .*

**Të nesërmen, pas shërbesës së zakonshme të mëngjesit, fillo kështu:**

Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshirona (3 herë).

Lavdi Atit..... Tani.....

Trini e Tërëshenjtë, mëshirona; o Zot, falna mëkatet tona; o Zot i madh, ndjei paudhësitë tona; o i Shenjtë, vështro dhe shëro sëmundjet tona, për emrin tënd.

Mëshiro, o Zot (tri herë).

Lavdi Atit..... Tani.....

Ati ynë që je në qiejt, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote si në qiell ashtu edhe mbi dhë. Bukën tonë të përditshme jepna neve sot; dhe falna fajet tona sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë; dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

Mëshiro, o Zot (12 herë).

Lavdi Atit..... Tani.....

Ejani t'i falemi e t'i biem ndër këmbë Perëndisë, Mbretit tonë.

Ejani t'i falemi e t'i biem ndër këmbë Krishtit Perëndisë dhe Mbretit tonë.

Ejani t'i falemi e t'i biem ndër këmbë vetë Krishtit Perëndisë dhe Mbretit tonë.

*Dhe psalmet e mëposhtme:*

### *Psalmi 22*

Zoti është bariu im dhe nuk do të më mungojë asgjë. Më vuri të rri në vend gjel-

bërimi, më rriti në ujra të qeta. Më solli shpirtin në vend, më udhëhoqi në rrugë drejtësie për emrin e tij; kështu që, edhe në shkofsha përmes hijes së vdekjes, nuk do të kem frikë nga ndonjë e keqe, se ti je bashkë me mua; purteka jote dhe shkopi yt, ato më ngushëllojnë. Përgatite përpara meje tryezë kundër atyre që më shtrëngojnë. Leve me vaj kryet tim edhe kupa jote do të më ujitë si shumë të fortë. Dhe përdëllimi yt do të jetë me mua gjithë ditët e jetës sime. Edhe do të rri në shtëpi të Zoti për gjithë jetën

### *Psalmi 23*

I Zotit është dheu dhe gjithçka është në të, bota edhe gjithë sa rrinë në të. Sepse ai e themeloi mbi detëra dhe e qëndroi mbi lumenj. Cili do të ngjitet në malin e Zotit a kush do të qëndrojë në vendin e tij të shenjtë? I ka duart pa faj dhe zemrën të qëruar, ai që nuk mori shpirtin, e tij më të kotë edhe nuk bëri bë të rreme kundër të afërmit të tij. Ky do të marrë bekimin nga Zoti dhe përëllim prej Perëndisë,

Shpëtimtarit të tij. Ky është brezi i atyre që kërkojnë Zotin, që kërkojnë fytyrën e Perëndisë së Jakovit. Ngreni dyert, o ju të parët; hiquni, o ju dyer të përjetshme, që të hyjë Mbreti i lavdisë. Cili është ky Mbret i lavdisë? Zoti i pushtetshëm dhe i fortë, Zoti i fuqishëm në luftë. Ngreni dyert, o ju të parët dhe hiquni, o ju dyer të përjetshme, se do të hyjë Mbreti i lavdisë. Cili është ky Mbreti i lavdisë? Zoti i fuqive, ky është Mbreti i lavdisë.

### *Psalmi 115*

Besova, prandaj fola, unë u përula fort. Dhe në kohë shtangieje thashë: çdo njeri është gënjeshtar. Si t'ia shpërblej Zotit, për të gjithë të mirat që më bëri? Kupë shpëtimi do të marr dhe emrin e Zotit do të thërres. Lutjet e mia do t'ia drejtoj Zotit, para gjithë popullit të tij. E nderuar është para Zotit vdekja e të drejtëve të tij. O Zot, unë jam shërbëtori yt, unë shërbëtori yt dhe bir i shërbëtores sate; Ti theve prangat e mia. Ty do të të sjell therore lavdërimi dhe në emrin e Zotit do të thërres.

Lutjet e mia do t'ia drejtoj Zotit para gjithë popullit të tij, në oborret e shtëpisë së Zotit, në mes teje, o Jeruzalem.

Lavdi Atit..... Tani.....

Aliluia, aliluia, aliluia. Lavdi më Ty, o Perëndi (3 herë).

Mëshiro, o Zot (3 herë).

*Bën tri metani dhe menjëherë thuhën  
troparet e mëposhtme:*

*Tingull tërthor II*

Mos i ve re paudhësitë e mia, o Zot, që linde prej Virgjëreshës, dhe pastroma zemrën duke e bërë tempull të Trupit dhe Gjakut tënd të kulluar; mos më hidh prej fytyrës sate; Ti që ke përdëllimin e madh të pamatur.

Lavdi Atit.....

Në kungimin e të Shenjtave të Tua si do të guxoj të afrohem unë i padenji? Se, në guxofsha të të afrohem bashkë me të denjët, rroba më tregon se s'është e Darkës dhe do t'i shkaktoj dënim shpirtit tim mëkatar. Pastroma, o Zot, ndotjen e shpirtit tim dhe shpëtomë si njeridashës.



Tani.....

Fajet e mia janë të panumërta, o Hyjlindëse; te Ti gjeta strehë, o e pastër, duke lypur shpëtim. Vështro shpirtin tim të sëmurë dhe lutju Birit tënd dhe Perëndisë sonë, që të më jepet falja e të këqijave që kam bërë, o e vetmja e bekuar.

*Ndërsa të Enjten e Madhe thuhet ky tropar:*

Kur nxënësit e lavdëruar në lajtoren e darkës ndriçoheshin, atëherë Juda i pabesë, nga sëmundja e argjenddashjes errësohej, dhe në gjykatës të paligj Ty, gjykatësin e drejtë, të dorëzon. Shiko, o argjenddashës, atë që përdori varje për këto; dhe largoj shpirtit të panginjur që guxoi të tilla kundër Mësuesit. O Zot, që je i mirë për të gjithë, lavdi më Ty.

*Pas këtyre:*

Mëshiro, o Zot (40 herë).

*Bëji metani sipas mundësisë dhe lexo me kujdes dhe përfitim për veten tënde, vargjet e mëposhtme:*

*Vargje që na mësojnë se si duhet t'u afrohem i Mistereve të kulluara:*

Kur dëshiron, o njeri, të kungohesh me Trupin e Zotit,

Afrohu me frikë, që të mos digjesh, se është zjarr.

Kur dëshiron të kungohesh me Gjakun hyjnor,

Më parë pajtohu me ata që të kanë hidhëruar

Dhe pastaj guxo të hash ushqimin mistik.

Para se të kungohesh me theroren e frikshme

të Trupit jetëdhënës të Zotit,

Lutu me dridhje kështu.

### *Urata e parë, e Shën Vasilit*

O Zot Iisu Krisht, Perëndia ynë, burim i jetës dhe i pavdekësisë, krijues i çdo krijese të dukshme dhe të padukshme, Bir i Atit pa fillim, i bashkëpërjetshëm dhe i

bashkëpafillim, që në ditët e fundit more trup nga mirësia e shumtë dhe u kryqëzove e u bëre theror për ne mosmirënjohësit e të pamendët dhe që me Gjakun tënd përtërite natyrën tonë të prishur prej mëkatit. Ti, o Mbret i pavdekshëm, prit dhe pendimin tim të mëkatarit, ul veshin tënd mbi mua dhe dëgjo fjalët e mia; sepse mëkatova kundrejt qiellit dhe përpara teje dhe s'jam i denjë të ngre sytë drejt lartësisë së lavdisë sate; se e zemërova mirësinë tënde, duke shkelur porositë e Tua, dhe duke mos dëgjuar urdhërat e Tua. Po Ti, o Zot, që e duron të keqen dhe që je zemërgjerë dhe mëshirëplotë, nuk më dorëzove që të humbas nga paudhësitë e mia, duke pritur kthesën time. Se vetë, o njeridashës, ke thënë me anën e profetit tënd: "Me dashje unë s'dua vdekjen e mëkatarit, por dua të kthehet e të jetë gjallë". Sepse nuk do, o Zot, që të humbasë vepra e duarve të Tua dhe as që kënaqesh me humbjen e njerëzve, po dëshiron që të shpëtojnë të gjithë dhe të njohin të vërtetën. Prandaj dhe unë i

mjeri, me gjithë që s'jam i denjë për qie-  
llin dhe për dheun, as për vetë jetën e për-  
kohshme, nga që ia kam nënshtruar tërë  
veten time mëkatit dhe u bëra rob i dëfri-  
meve dhe prisha ikonën tënde, por, meqe-  
nëse jam vepër dhe krijesa jote, nuk  
dëshpërohem për shpëtimin tim, por duke  
u mbështetur në zemërgjerësinë tënde të  
pamatur të afrohem. Pranomë, pra dhe  
mua, o Krisht njeridashës, sikurse lavi-  
rën, kusarin, doganierin dhe birin e  
shthurur; dhe ngrema barrën e rëndë të  
mëkateve, Ti që ngre mëkatet e botës dhe  
që shëron sëmundjet e njerëzve; Ti që i  
fton pranë Teje dhe i preh të munduarit  
dhe të ngarkuarit; Ti që nuk erdhe të  
ftosh në pendim të drejtët po mëkatarët;  
Ti pastromë dhe mua prej çdo ndyrësie  
trupit dhe shpirti, mësomë të bëj me frikën  
tënde çdo vepër të shenjtë, që duke pritur  
me dëshmi të pastër të ndërgegjes sime  
pjesën e të Shenjtave të Tua, të bashko-  
hem me Trupin dhe Gjakun tënd të she-  
njtë dhe të të kem Ty si banues dhe  
ndenjës tek unë, bashkë me Atin dhe

Shpirtin tënd të Shenjtë. Po, o Zot Iisu Krisht Perëndia im, mos m'u bëftë për dënim kungimi me Misteret e Tua të kulluara dhe jetëbërëse, as mos u bëfsha i sëmure shpirtërisht dhe trupërisht duke u kunguar me to padenjësisht. Por jepmë që gjer në ditët e fundit të jetës sime të marr pa dënim pjesën e të Shenjtave të Tua, për kungim të Shpirtit të Shenjtë, për jetë të përjetshme dhe mbrojtjen e mirëpritur përpara gjykatores sate të frikshme; që edhe unë bashkë me gjithë të zgjedhurit e Tu të bëhem pjesëtar i të mirave të Tua të përjetshme, të cilat i ke bërë gati për ata që të duan, o Zot, prej të cilëve je i lavdëruar në jetë të jetëve. Amin.

*Urata e dytë, e po këtij Shenjti*

E di, o Zot, se padrejtësisht kungohem me Trupin tënd të kulluar dhe me Gjakun tënd të çmuar dhe se jam fajtor dhe po ha e po pi dënimin për vete duke mos çuar Trupin dhe Gjakun tënd, Krishtit dhe Perëndisë tim; po duke marrë kurajë nga dhembshuritë e Tua, po vij tek Ti, që

ke thënë: “Ai që ha trupin tim dhe pi gjakun tim, mbetet tek unë dhe unë tek ai”. Le të të vijë pra keq, o Zot, dhe mos më dëno mua fajtorin, po tregohu i mëshirshëm për mua; dhe këto të Shenjta le të jenë për mua shërim, pastrim, ndriçim, ruajtje dhe shpëtim e shenjtërim i shpirtit dhe i trupit, dëbim i çdo fantazie, i çdo pune të ligë, i çdo veprimi djallëzor që kryhet mendërisht në gjymtyrët e mia, kurajë dhe dashuri për Ty, ndreqje dhe forcim në jetë, në të mirën dhe përsosjen, plotësim i porosive, kungim i Shpirtit të Shenjtë, mjet për në jetën e përrjetshme, mbrojtje e mirëpritur para gjykatores sate të trembshme; dhe jo për gjykim ose dënim.

*Urata e tretë, e Shën Joan Gojartit*

O Zot, Perëndia im, e di që nuk jam i denjë, as i aftë që të hysh nën mbulesën e shtëpisë së shpirtit tim, sepse është e shkretë dhe e rënë dhe s’gjen tek unë vend të denjë për të ulur kryet. Por, siç e ule veten së larti për ne, ule dhe tani në

përruljen time. Dhe siç denjove të shtrihesh në shpellë dhe në grazhd të kafshëve, denjo të hysh dhe në grazhdin e shpirtit tim të paarsyeshëm dhe të trupit tim të njollosur. Dhe siç nuk të erdhi rëndë të hysh e të hash bashkë me mëkatarët, në shtëpinë e leprozit Simon, denjo dhe tani të hysh edhe në shtëpinë e shpirtit tim të përrulur, të leprozit dhe mëkatarit. Dhe siç nuk e largove laviren dhe mëkatarin që është si unë, kur u afrua dhe të preku, kështu ki mëshirë dhe për mua mëkatarin që po të afrohem e po të prek. Dhe siç nuk të erdhi ndot nga goja e saj e ndyrë kur të puthi, mos të të vijë ndot as nga goja ime që është më e ndyrë e më e fëlliqur se e saja, as nga buzët e mia të ndyra e të shëmtuara dhe as nga goja ime më e fëlliqur. Po le të jetë për mua thëngjilli i Trupit tënd të Tërëshenjtë dhe i Gjakut tënd të çmuar, shenjtërim, ndriçim dhe forcim i shpirtit dhe i trupit tim të përrulur, lehtësim nga barra e fajeve të shumta, ruajtje kundër çdo veprimi djallëzor, largim dhe fre për zakonet e mia të kota e

dinake, shtypje e pasioneve, ruajtje e porosive të Tua, ardhje e hirit tënd hyjnor dhe pjesëmarrje në mbretërinë tënde. Sepse nuk vij tek Ti indiferent, o Krisht Perëndi, por me shpresë në mirësinë tënde të patregueshme dhe që të mos mbe-tem larg për shumë kohë nga kungimi yt dhe kështu të kapem prej ujkut të mençur. Prandaj të lutem Ty, të vetmit të shenjtë, o Zot, shenjtëroma shpirtin dhe trupin, mendjen dhe zemrën dhe gjithë mendimet e mia, përtërimë krejt, rrënjos në gjymtyrët e mia frikën tënde dhe bëje që të mos zhduket nga unë shenjtërimi yt. Dhe ji për mua ndihmës dhe përkrahës, duke ma drejtuar jetën në paqe dhe duke më bërë të denjë të qëndroj bashkë me Shenjtorët nga e djathta jote, me ndërmjetimet dhe uratat e Nënës sate të tërëkulluar dhe të meshëtarëve të Tu pa trup e të kulluar që të shërbejnë, si dhe të gjithë Shenjtorëve që të kanë pëlqyer prrej jete. Amin.



*Urata e katërt, e po këtij Shenjti*

Nuk jam i denjë, o Zot i madh, që të hysh në mbulesën e shpirtit tim, po meqë Ti si njeridashës denjon të banosh tek unë, po marr guxim e po të afrohem. Urdhëromë të çel dyert, të cilat Ti i ndërtove dhe hyr me njeridashjen tënde siç e ke thënë. Hyr që të më ndriçosh mendjen e errësuar. Edhe besoj se këtë do ta bësh; sepse as lavirën që të erdhi me lot nuk e largove, as kusarin që njohu mbretërinë tënde nuk e le, as doganierin që u pendua nuk e dëbove dhe as nga ndjekësi që u kthye tek Ti nuk hoqe dorë, po të gjithë sa kanë ardhur të penduar tek Ti i rendite në shoqërinë e miqve të Tu, Ti që je i vetmi i bekuar përgjithmonë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

*Urata e pestë, e po këtij Shenjti*

O Zot Iisu Krisht, Perëndia im, dobëso, ler, ki mëshirë dhe falmi mua shërbëtorit tënd mëkatar dhe të padenjë gjithë rëniet në mëkat, fajet dhe gabimet sa kam

kryer, që në të ritë tim e gjer në këtë ditë e në këtë orë, me dije ose pa dije, me fjalë, me punë a me mendje, me kujtesë e me gjithë ndjesitë e mia. Dhe me ndërmjetësimet e asaj që të lindi pa farë, të Nënës sate të tërëkulluar dhe gjithmonë Virgjëreshës Mari, që është e vetmja shpresë imja e paturpëruar, mbrojtëse dhe shpëtimi im, bëmë të denjë që pa dënim të kungohem me Misteret e Tua të kulluara, të pavdekshme, jetëdhënëse e të trembshme, për ndjesë fajesh dhe jetë të përjetshme, për ndriçim, për forcim, për shërim, për shëndet të shpirtit dhe të trupit dhe për shlyerjen e zhdukjen e gjykimeve, mendimeve dhe zakoneve të mia të liga, të epsheve të natës dhe të çdo fryme të ligë e të errët. Se jotja është mbretëria, fuqia dhe lavdia, nderi dhe adhurimi, bashkë me Atin e me Shpirtin e Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

*Urata e gjashtë, e Shën Joan  
Damaskinoit*

O Zot Iisu Krisht Perëndia ynë, Ti që si i mirë dhe njeridashës ke pushtet të falësh fajet e njerëzve, mos i ve re të gjitha fajet e mia, të bëra me dije dhe pa dije dhe bëmë të denjë që pa dënim të kungohem me Misteret e Tua të hyjshme, të lavdëruara, të kulluara dhe jetëbërëse, jo për mundim, as për shtim të mëkateve, po për pastrim e shenjtërim dhe për fitim të jetës të mbretërisë së ardhshme, për mbrojtje e ndihmë dhe dëbim të kundërshtarëve, dhe për shlyerje të fajeve të mia të shumta. Se Ti je Perëndi mëshirash dhe dhembshurish dhe njeridashjeje dhe Ty ta drejtojmë lavdinë bashkë me Atin e me Shpirtin e Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

*Urata e shtatë, e po këtij Shenjti  
(ose më mirë e Shenjt Simeonit,  
Theolog i ri)*

Prej buzësh të ndyra,

Prej zemre të fëlliqur,  
Prej gjuhe të papastër  
Dhe shpirti të njollosur,  
Prano lutje, o Krishti im.  
Dhe duke mos i vënë re  
As fjalët dhe as sjelljet,  
As edhe paturpësitë,  
Jepmë Ti, o Krisht, kurajë  
Të të them sa unë mendoj,  
Bile dhe mësomë  
C'të veproj e ç'të them.  
Mëkatova më shumë se lavira,  
E cila porsa mësoi  
Se ku ishe duke ndenjtur,  
Shkoi me vrap e bleu mira  
Edhe erdhi me guxim  
Që të të lyejë këmbët,  
Ty, Krishtit tim, Zotit dhe Perëndisë tim.  
Dhe sikurse nuk dëbove  
Atë që të erdhi me zemër,  
Ashtu mos më përbuz edhe mua,  
Ti, o Perëndi dhe Fjalë,

Por m'i fal këmbët e Tua  
T'i pushtoj edhe t'i puth  
Dhe me lotët si burim  
Të guxoj që të t'i lyej,  
Si me mirë të shumëçmuar.  
Lamë me lotët e mi  
Dhe me ta pastromë, o Fjalë.  
Falmi fajet që kam bërë  
Dhe dhuromë për to ndjesë.  
Ti m'i njeh të gjithë mëkatet,  
Ti i di plagët e mia,  
Ti m'i sheh shenjat e goditjeve,  
Po ndërkaq ma di dhe besën  
Dhe dëshirën e shikon,  
Dhe dëgjon dhe psherëtimat;  
S' të shpëton, o Zoti im,  
Ty, krijues dhe shpërblyes,  
Asnjë pikë e vogël lotësh,  
Bile dhe asnjë pjesë e pikës.  
Dhe ato që s'i kam bërë  
Sytë e Tu, o Zot, i dinë  
Dhe në librin tënd të jetës

Gjenden që të gjitha shkruar.  
Shih tani përuljen time,  
Shih se sa jam i munduar  
Dhe m'i fal të tëra fajet,  
Ti, o Zot i gjithësisë,  
Që me zemër të qëruar  
Dhe me mendje të drithtuar  
Dhe me shpirt krejt të dërrmuar  
Të marr pjesë në të Shenjtat  
Dhe të kulluarat Mistere,  
Me të cilat kush kungohet  
Me një zemër të kulluar  
Fiton jetën dhe hyjnohet.  
Sepse Ti, o Zot, ke thënë:  
Ai që ha Trupin tim  
Edhe Gjakun tim e pi,  
Ai mbetet tek Unë  
Dhe Unë mbetem tek ai.  
Dhe është fjalë e vërtetë  
Kjo e Perëndisë dhe e Zotit;  
Se ai që po kungohet  
Me dhuratat hyjnore,

Nuk mbetet i vetmuar,  
Po me Ty, o Krisht, bashkohet,  
Që je dritë e trishkëlqyer,  
Që ndriçon botën e tërë.  
Pra, që të mos mbetem vetëm  
Dhe pa Ty, o jetëdhënës,  
Që je fryma, jeta ime,  
Dhe gëzimi im i plotë  
Dhe shpëtim i gjithë botës,  
Të erdha siç më sheh, me lot  
Dhe me shpirt krejt të dërrmuar,  
Duke lypur që të marr  
Shpëtim për të gjitha fajet  
Dhe të kungohem pa dënim me Misteret  
Jetëdhënëse e të shenjta,  
Që të mbetesh siç ke thënë  
Bashkë me mua të mjerin  
Dhe që mos ai i paudhi,  
Duke më gjetur larg hirit tënd  
Të më rrëmbejë dinakërisht  
Dhe të më gënjejë e të më largojë  
Nga fjalët e Tua hyjnore.

Për këtë në këmbë të bie  
Edhe të thërres nga zemra,  
Siç prite birin e shturur  
Dhe laviren që të erdhi,  
Pritmë dhe mua të ndyrin  
Dhe të shtururin, o përdëllyes,  
Që po vij tani tek Ti  
Me shpirt krejt të dërrmuar.  
Unë, o Shpëtimtar, e di  
Se asnjë tjetër si unë s'ka mëkatuar  
Dhe asnjë si unë s'ka kryer  
Kaq vepra të këqija.  
Po di prapë dhe një gjë tjetër,  
Se edhe zemërdhembshuria  
Dhe mëshirë e Perëndisë,  
Qëndrojnë përmbi mëkatet  
Dhe paudhësitë e mia.  
Se Ti me mëshirë e dhimbje  
Ata që pendohen me zemër  
I pastron edhe i ndrit  
Dhe i bën bij të dritës  
Dhe pjesëtarë të hyjnisë sate,



Duke punuar pa pushim.  
Dhe çka është më e çuditshme  
Dhe për engjëjt e për njerëzit  
Ti flet me ta shpesh herë,  
Si me miq shumë të singertë,  
Këto pra, guximtar më bëjnë  
Dhe më japin, o Krisht, krahë;  
I mbështetur në mirësitë,  
Që ke bërë Ti për ne,  
Plot me gaz, po dhe me dridhje,  
Po kungohem sot me zjarrin  
Dhe, o çudi e mahnitshme,  
Duke qenë si bar i thatë,  
Po vesohem pasurisht,  
Si edhe ferra dikur,  
Që flakë nxirrte e nuk digjej.  
Ja pra, pse tani dhe unë  
Me mendje, zemërgjymtuar mirënjohëse  
Të shpirtit dhe të trupit tim,  
Të falem, të madhëroj, të lavdëroj, o  
Perëndia im  
Ty, që je i bekuar,

Tani e përherë e në jetë të jetës. Amin.

*Urata e tetë, e Shën Simeon Metafrastit*

O Zot, i vetmi i pastër dhe i panjollshëm,  
Ti që nga dhembshuria e patregueshme e  
njeridashjes sate, more krrejt natyrën  
tonë nga gjiri i pastër dhe virgjëror I asaj  
që të lindi në mënyrë të përmbinatyr-  
shme me ardhjen e Shpirtit hyjnor dhe  
mirëdashjen e Atit të përjetshëm, o Iisu  
Krisht, urtësi e Perëndisë, paqe dhe fuqi;  
Ti që pranove në trupin tënd pësimet  
jetëbërëse dhe shpëtimtare: Kryqin, gozh-  
dët, shtizën, vdekjen, bëmi të vdekura pa-  
sionet trupore që më prishin shpirtin; Ti  
që me varrimin tënd plaçkite mbretërinë  
e ferrit, varros mendimet e mia dinake  
me anën e mendimeve të mira dhe shpër-  
ndai frymët e liga; Ti që me ngjalljen të-  
nde të triditshme dhe jetëprurëse ke ngri-  
tur stërgjyshin tonë të rënë, ngrëmë dhe  
mua të kredhurin në mëkate, duke më  
vënë përpara shembuj pendimi; Ti që me  
ngritjen tënde në qiell e bërë të perëndi-  
shëm trupin që more dhe e nderove me

ndejtjen nga e djathta e Atit, bëmë të denjë me kungimin e Mistereve të shenjta të fitoj vendin nga e djathta e atyre që kanë shpëtuar; Ti që me zbritjen e Shpirtit ngushëllimtar i bëre enë të nderuar nxënësit e Tu të shenjtë, tregomë dhe mua banesë të ndejtjes së tij; Ti që ke për të ardhur prapë të gjykosh botën me drejtësi, bëmë të denjë që edhe unë të të pres në retë, Ty, gjykatësin dhe formuesin tim, bashkë me të gjithë shenjtoret e Tu; që pa pushuar të të himnoj e të të lavdëroj bashkë me Atin tënd pa fillim dhe Shpirtin tënd të Tërëshenjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

*Urata e nëntë, e Shën Joan Damaskinoit*  
Përpara dyerve të tempullit tënd qëndroj dhe nga mendimet e frikshme nuk largohem. Po Ti, o Krisht Perëndi, që drejtësove tagrambledhësin e përdëlleve Kanaanën dhe i çele kusarit dyert e parajsës, çelma dhe mua zemrën e njeridashjes sate dhe pritme se po të vij pranë e po

të mbështetem, siç prite laviren dhe gjak-  
rrjedhësen; se kjo duke prekur cepin e  
rrobes sate gjeti shumë lehtë shpëtim dhe  
e para duke mbajtur këmbët e Tua të ku-  
lluara, mori zgjidhjen e mëkateve; por  
bëj që edhe unë i ngrati, i cili guxoj të  
pres tërë trupin tënd, të mos digjem; po  
pritmë si ato dhe ndriçomi ndjenjat e  
shpirtit, duke djegur krimet e mia të më-  
katit me ndërmjetimet e asaj që të lindi  
pa farë dhe të fuqive qiellore, se i bekuar  
je në jetë të jetëve. Amin.

*Urata e dhjetë, e Shën Joan Gojartit*

Besoj, o Zot, dhe pohoj se Ti je me të vër-  
tetë Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë, që  
erdhe në botë për të shpëtuar mëkatarët,  
nga të cilët i pari jam unë. Edhe besoj se  
ky vetë është Trupi yt i kulluar dhe ky  
është vetë Gjaku yt i çmuar. Të lutem  
pra, mëshiromë dhe ndjemi fajet, të bëra  
me dashje dhe pa dashje, me fjalë, me  
punë, me dije edhe pa dije; dhe bëme të  
denjë të kungohem pa dënim me Misteret

e tua të kulluara, për ndjesë mëkatesh  
dhe për jetë të amshuar. Amin.

*Dhe duke shkuar të kungohesh, thuaj me  
zë të ulët këto vargje të Metafrastit:*

Ja tek po shkoj në Kungatën hyjnore,  
Mos më digj, o Krijues, kur të kungohem.  
Se Ti je zjarr që i djeg ata që s'janë të  
denjë.

Po pastromë prej çdo njolle.

*Pastaj këtë tropar:*

Në Darkën tënde mistike, o Bir i Perëndisë,  
më merr sot pjesëtar; se nuk do t'ua  
them armiqve të tu Misterin, nuk do të të  
jap të puthur si Juda; por duke të pohuar si  
kusari, therrës: Kujtomë, o Zot në mbretërinë  
tënde.

*Pas troparit thuaj këto vargje:*

Tmerrohu, o njeri, kur shikon Gjakun  
hyjnor;

Sepse është zjarr që djeg të padenjët.

Trupi hyjnor më ushqen dhe më hyjnizon,

Më hyjnizon shpirtin dhe më ushqen mendjen mrekullisht.

*Dhe këtë tropar:*

Më ngazëllove me mall, o Krisht, dhe më ndryshove me dashurinë tënde të perëndishme; po digji dhe mëkatet e mia me zjarr të palëndshëm dhe bëmë të denjë të rrafshohem me gëzimin tek Ti, që të madhëroj duke kërcyer, të dy ardhjet e Tua, o i Mirë.

Ndër shkëlqimet e Shenjtorëve të Tu, si do të hyj unë i padenji? Se në guxofsha të hyj bashkë në nusëroren, këmisha më tregon se s'është e dasmës dhe i lidhur do të nxirrem jashtë prej engjëjve. Pastro, o Zot, ndyrësinë e shpirtit tim dhe shpëtomë si njeridashës.

*Pastaj këtë uratë:*

O Zot njeridashës, Zot Iisu Krisht, Perëndia im, të mos më bëhen për gjyq këto të Shenjta, ngaqë jam i padenjë; po për pastrim dhe shenjtërim shpirti dhe trupi dhe të bëhem i denjë për jetën dhe mbretërinë tënde të ardhme. Është mirë për mua t'i ngjitem Zotit, dhe tek Zoti të vë shpresën e shpëtimit tim.

*Dhe prapë:*

Në Darkën tënde mistike, o Bir i Perëndisë, merrmë sot pjesëtar; se nuk do t'ua them armiqve Misterin, as që do të të jap puthje si Juda; por si kusari po të pohoj: Kujtomë, o Zot, kur të vij në mbretërinë tënde.

*Dhe kështu me shpresëtari të madhe,  
shko dhe kungohu.*

## *Urata Falenderimi pas Kungimit*

*Vargje nxitëse për falenderim:*

Si të kungohesh me Dhuratat jetëdhënëse dhe mistike, himno menjëherë dhe falendero me të madhe Perëndinë, duke thënë me zemër dhe shpirt këto:

Lavdi me ty, o Perëndi (3 herë).

*Dhe këtë uratë:*

Të falenderoj, o Zot Perëndia im, se nuk më le mua mëkatarin, po më bëre të denjë të jem pjesëtar i të Shenjtave të tua. Të falenderoj se më bëre të denjë, mua të padenjin, të kungohem me dhuratat e tua të kulluara dhe qiellore. Po, o Zot njeri-dashës, Ti që për ne durove vdekje, u ngjalle dhe na fale këto Mistere të trembshme dhe jetëdhënëse për të mirën dhe shenjtërimin e shpirttrave dhe të trupave tanë, bëj që edhe për mua të jenë këto për shërim shpirti dhe trupi, për dëbim të çdo gjëje kundërshtare, për ndriçim të syve të zemrës sime, pastrim për fuqitë e mia shpirtërore, besë e paturpëruar, për da-